

RREGULLAT E PROCEDURAVE PER STACIONIN E TUZIT

Ne fuqi prej dates 15 Qershor 2017 deri ne daten 9 Dhjetor 2017

Podgorice, viti 2017

Stacioni I Tuzit i përket njësisë së Podgoricës dhe kryen operacione komerciale të transportit të mallrave (ngarkesave), si dhe operacione lidhur me inspektimin teknik në fushën e transportit hekurudhor të të gjithë llojeve të mallrave dhe të gjithë operacioneve të ndërlidhura me to.

1. OPERACIONET DHE CAKTIMET E DETYRAVE TE NJËSISË SE TUZIT

Operacionet e transportit të mallrave (ngarkesave) janë detyra që lidhen me ngarkimin / shkarkimin e mallrave. Operacionet e transportit të mallrave në stacionin e Tuzit përfshijnë urdhërimin dhe renditjen e mjeteve lëvizëse, zhdoganimin, ngarkimin, transportimin, shkarkimin, shpërndarjen etj.

Detyrat teknike të inspektimit përfshijnë inspektimin e vagoneve dhe trenave në trafikun ndërkombëtar, testet e frenave dhe detyrat brenda kompetencës së inspektimit teknik.

Detyrat që lidhen me vagonet e ngarkesave përfshijnë njohjen e llojeve të vagonave, pajisjeve të ngarkesave, paletave dhe kontejnerëve; procedurat për trajtimin e vagonave (përfshirë manovrimin dhe shitjen), pajisjeve të ngarkesave, paletave dhe kontejnerëve; përcaktimin e disponueshmërisë dhe nevojave për vagone, pajimeve për ngarkesa, paleta dhe kontejnerë; alokimin (ndarjen) dhe përdorimin me kosto efektive të vagonave, pajisjeve të ngarkesave, paletave dhe kontejnerëve; perlllogaritjet për përdorimin e vagonave.

2. VENDET E PUNËS TË ORGANIZUARA NE SISTEM NË STACIONIN E TUZIT

Vendet e punës të organizuara në sistem në stacionin e Tuzit janë si në vijim:

1. Komerçalisti i Transportit (transportuesi)
2. Përgjegjësi i trenit (kryetari i trenit)
3. Inspektori i vagoneve

Përshkrimi i punës së Komerçalistit të Transportit (transportuesi) në Stacionin e Tuzit

- Kryen inspektime komerciale të trenit;

- Kryen dorëzimin komercial të vagoneve dhe ngarkesave së bashku me personelin administrativ të hekurudhës së huaj;

- Plotëson formularët K-200 dhe Kol-65, i krahason ato me gjendjen aktuale në tren dhe i dërgon të dhënat ne departamentin e Shërbimit për perlllogaritjen e çmimit të qirave të vagonëve te huaj;
- Kontrollon dhe krahason dokumentet shoqëruese;
- Përgatit Raportin Përmbledhës dhe e paraqet atë tek doganat dhe autoritetet e tjera të kontrollit së bashku me dokumentet shoqëruese;
- Mban shënime mbi përdorimin e vulave të vendosura dhe të çmontuara dhe i mban ato; Nxjerr Raportin Formal CIT-20;
- Nëse është e nevojshme, lëshon orarin e levizjes/manovrimit/kalimit S-22 dhe e dërgon atë për tek dispeçeri trenit;
- Kryen detyra të tjera siç kërkohet nga Shefi i Njësisë së Podgoricës, dhe
- Raporton tek Shefi i Njësisë.

Përshkrimi i punës së Përgjegjesit/Kryetarit te trenit në Stationin e Tuzit

- Bën inventarizimin e vagonëve në përbërjen e trenit dhe nxjerr dokumentet shoqëruese për trenin;
- Kontrollon përbërjen e trenit;
- Kontrollon saktësinë e ngarkesës së vagonëve dhe funksionalitetin e kutisë së shpejtësisë;
- Llogarit SKM dhe PKM;
- Kryen inspektime teknike të vagonëve dhe testit të frenëve, në mungesë të Inspektorit të vagonit;
- Siguron vagonët nga vetë-lëvizja, në mungesë të personelit të levizjes/manovrimit/shmangies;
- Merr dhe dorëzon dokumentet shoqëruese për/nga drejtuesi i trenit (makinisti);
- Kryen punimet e inspektorit te levizjes (punonjësve përgjegjës per levizjen/manovrimin), nëse është e nevojshme;
- Kontrollon pastërtinë dhe funksionalitetin e brendësisë së vagonit bosh;
- Kryen kontrollin e saktësisë së vulave në vagonët të ngarkuar;

- Kryen detyra të tjera të kërkuara nga Shefi i Njesisë së Podgoricës dhe të dispecerit të Trenit;
- Raporton tek Shefi i Njesisë.

Përshkrimi i punës i Inspektorit të vagonëve

- Inspektimi teknik i vagonave për komunikacion dhe përdorim, individualisht dhe në përbërje të trenave;
- Përcaktimi i defekteve, deshtimeve dhe dëmtimeve të vagonave dhe përcaktimin e procedurës së përshtatshme për trajtimin e tyre;
- Kontrollimi i përbërjes së trenit;
- Kryen teste të frenave;
- Kontrollon korrektësinë e ngarkimit dhe sigurimit të ngarkesës;
- Kryen monitorim të vazhdueshëm të vagonëve në operim (veprim) me qëllim të zbulimit në kohë të ngjarjeve të dëmshme dhe dëmtimeve të vagonëve në shfrytëzim;
- Kryen etiketimin e vagonëve dhe përcakton procedurën për trajtimin me vagonë jo-operative;
- Mban regjistra TC;
- Lidh dhe shkëput kabllon e ngrohjes sipas procesit të punës teknologjike;
- Inspekton dhe pranon vagona pas riparimeve;
- Pret për trenat në mbërritje dhe i dërgon ato në nisje;
- Vëzhgon lokomotivën e manovrimit/trafikut të stacionit për të zbuluar dëmtimet në kohën e duhur për të shmangur largimin e vagonëve jashtë shërbimit;
- Zbaton Manualët dhe Rregulloret e Punës si në trafikun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar;
- Monitoron dhe zbaton ndryshimet e rregulloreve;
- Informon për komandat dhe telegramet në librin e komandave TK-11;
- Është i detyruar të ndjekë kualifikimin (arsimin) dhe trajnimin;
- Kryen detyra të tjera me kërkesë të menaxherit përgjegjës në pajtim me ligjin dhe rregulloret.

3. ORGANIZIMI I PUNËS NË STATIONIN E TUZIT

1. Orari i manovrimit S-22

Nëse kërkohet operacioni i shmangies, Orari i manovrimit/shmangies do të lëshohet nga Komercialisti i Transportit në tri kopje; origjinali është lënë në broshurë dhe dy kopjet e mbetura do të dorëzohen në stafin e ZICG (Dispeçerit të trenit). Përveç Dispeçerit të Trenit, Orari i manovrimit/shmangies do të nënshkruhet gjithashtu nga Asistenti i makinistit të Trenit, i cili do t'ia kthejë një kopje të S-22 Kryetarit të trenit duke treguar kohën dhe datën e detyrës së kompletuar të manovrimit/shmangies.

2. Funksionaliteti teknik i vagonave

Funksionimi teknik i vagonave përcaktohet nga Inspektori i vagonave pas mbërritjes së trenit në stacion, pra përpara nisjes së trenit nga stacioni, inspektimi teknik i vagonave duhet të kryhet përpara se vagonat të merren nga hekurudha fqinje. Dorëzimi dhe marrja e vagonëve, mallrave, dokumenteve, kontejnerëve, paletave dhe pajisjeve të ngarkesave kryhet në përputhje me rregulloret ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje - Konventa mbi transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF) dhe Rregullorja që rregullon përdorimin reciprok të vagonëve në trafikun ndërkombëtar (RIV). Dorëzimi dhe marrja e vagonëve kryhet në stacionin e përbashkët kufitar të Tuzit.

Në rast të mosmarrëveshjes në stacionin e përbashkët kufitar të ndërlidhur me marrjen e dorëzimit që rrjedh nga arsye teknike ose komerciale, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Komisioni i Përbashkët.

4. MARRJA DHE DOREZIMI I MALLRAVE DHE DOKUMENTEVE

Marrja dhe dorëzimi i mallrave dhe dokumenteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat për transportin ndërkombëtar të mallrave (CIV dhe CIM) duke përfshirë ndryshimet e mëposhtme:

- Lista e kalimeve K-200 është përpiluar në pesë kopje. Pasi të përfundojë kontrolli i ceshtjeve/artikujve dhe dokumenteve, sipermarrja hekurudhore e cila plotëson Listën e kalimeve fut kohën e marrjes së dorëzimit dhe verifikon me nënshkrimin e tij dhe vulën e stacionit dhe kthen tre kopje për sipermarrjen hekurudhore që kreu dorëzimin.
- Në përputhje me dispozitat e CIM-it, nëse bëhet raporti mbi padinë, duhet të tregohet në të gjitha kopjet e Listës së kalimeve.
- Çdo korigjim i Listës së kalimeve duhet të bëhet në mënyrë që teksti origjinal të jetë i dukshëm. Këto korigjime duhet të verifikohen me nënshkrimin e punonjësit që dorëzon ngarkesën dhe vulën e stacionit duke përfshirë datën.
- Ri-ngarkimi dhe riparimi i ngarkesës mund të kontrollohet në stacionin kufitar me shpenzimet e sipermarrjes hekurudhore që kreu dorëzimin, nëse sipermarrja hekurudhore që kreu marrjen në dorëzim pajtohet të kryejë rimbushjen (ri-ngarkimin) dhe riparimin e ngarkesave.

5. MARRJA DHE DOREZIMI TREGTAR I DËRGESAVE DHE VAGONEVE

Marrja dhe dorëzimi i dërgesave dhe i vagonave bëhet në bazë të konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare:

- Konventa mbi transportin ndërkombëtar hekurudhor - COTIF
- Rregullat uniforme për marrëveshjen për transportin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave - CIM
- Manuali për transportin e mallrave CIT (GTM-CIT)
- Manuali i Flete- Ngarkesës CIM (GLV-CIM)
- Manuali për Fletë- ngarkesënCIM për transport të kombinuar (GLV-TC)
- Manuali i Shënimit të Vagonëve (GLW-CUV)
- Rregullorja e transportit të mallrave të rrezikshme RID2015
- Marrëveshja për trafikun ndërkombëtar të mallrave me hekurudhe - SMGS.

Pas mbërritjes së trenit në stacionin e dorëzimit dhe pas dorëzimit të trenit, një përfaqësues i transportuesit për kryen dorëzimin duhet të dorëzojë dokumentet mbështetëse që përmbajnë Listën e kalimeve K-200, Fletengarkesën duke përfshirë të gjitha anekset e përmendura në nenin 9 të Flete-ngarkesës, raportin mbi kalimet e vagonëve Kol-65 dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë ngarkesën tek përfaqësuesi i transportuesit që kryen marrjen në dorëzim.

Për trenat që nisen nga stacioni kufitar pas inspektimit komercial të trenit, përfaqësuesi i transportuesit që kryen dorëzimin duhet të dorëzojë dokumentet shoqëruese tek përfaqësuesi i transportuesit që kryen marrjen në dorëzim.

Inspektimi komercial dhe dorëzimi i trenit kryhen së bashku nga përfaqësuesit e autorizuar të operatoreve hekurudhorë.

Shpenzimet për dorëzimin e trenit në stacionin kufitar, të cilat zgjasin më shumë se sa janë parashikuar, barten nga sipermarrja hekurudhore që shkaktoi vonesën. Kjo kohë duhet të tregohet në Listën e Dorëzimit K-200.

Dorëzimi i ngarkesave në vagona të hapura me mbulesa, kontejnerë dhe vagona të mbyllur të vulosur kryhet në mënyrë simbolike me dokumentet e transportit, dokumentet shoqëruese dhe Listën e kalimeve K-200. Këto dërgesa duhet të vulosen me të paktën një vulë në gjendje të mirë (nga hekurudhat, doganat ose vulat e dërguesve) në përputhje me Aneksin 24 të Manualit GTM-CIT për transportin e mallrave.

Nëse dërguesi(t) ka vënë vulën e tij(tyre) zyrtare në vagon, ata duhet të tregojnë numrin dhe etiketën e tyre në seksionin 21 të flete- ngarkesës CIM. Megjithatë, nëse dërguesi ka vënë vulat e tij në vagon, por nuk kanë treguar të dhënat mbi vulat në fletën e dërgesës (flete-ngarkesën), kjo nuk do të jetë arsye për refuzimin e vagonëve në dorëzimin ndërmjet përfaqësuesve të autorizuar të operatoreve hekurudhorë.

Koha e dorëzimit tregohet në listën e dorëzimit të K-200 dhe Raportin mbi kalimet e vagonëve Kol-65 paraqet kohën e përfundimit të inspektimit teknik dhe komercial të trenit dhe konsiderohet si marrje e vërtetë dhe dorëzimi i kryer ndërmjet perfaqësueve të autorizuar të operatoreve hekurudhorë.

Marrja e ngarkesave me listën e nënshkruar të kalimeve K-200 dhe Raportin mbi kalimet e vagonëve Kol-65 të cilat janë refuzuar nga autoritetet kompetente shtetërore (dogana, policia, inspektimet) duhet të kthehen sa më shpejt në vendin fqinjë. Siper marrja hekurudhore që kryen dorëzimin do të marrë përsëri mbrapsht ngarkesën e tillë. Përgjegjësi i marrjes në dorëzim të siper marrjes hekurudhore që kryen marrjen do të kalojë (shenjojë) vagonin e refuzuar nga Lista e kalimeve K-200 dhe Raporti mbi kalimin e kamionëve Kol-65, duke treguar arsyen e refuzimit në seksionin "Vërejtje", e verifikon me nënshkrimin dhe vulën e tij dhe tregon kohën e refuzimit të vagonit.

6. PËRMBLEDHJE E STANDARDEVE PËR OPERACIONE DHE VEPRIME TË CAKTUARA ME VAGONET DHE TRENAT

Listat e mëposhtme e ekzekutimit të operacioneve për Stationin e Tuzit është përbërë nga:

- Grafiku i trajtimit të vagonëve të mallrave të tranzitit në drejtimin Mali I Zi – Shqipëri (HSH)
- Grafiku i trajtimit të vagonëve të mallrave të transitit në drejtim Shqipëri (HSH)- Mali I Zi

- Operacioni (funksionimi) i heqjes së sinjalit përfundimtar për trenat pa staf shoqerues, si dhe për trenat me numër të reduktuar të stafit dhe dorëzimin e tij tek drejtuesi i lokomotivave në Stationin e Tuzit, kryhet nga një punonjës.

- Marrja e trenave dhe dokumenteve shoqëruese si dhe inspektimi komercial dhe teknik i trenave të mallrave të drejtpërdrejta kryhet në stacionin e Tuzit menjëherë pas mbërritjes së trenit. Kjo procedure kryhet në këtë mënyrë:

Komercialisti I Transportit, kryetari I trenit dhe inspektori i trenit presin trenin. Komercialisti merr dokumentet nga drejtuesi i trenit dhe pastaj kryhet inspektimi komercial dhe teknik i trenit. Komercialisti I Transportit merr përsipër Listën e kalimeve K-200 dhe të gjitha flete-ngarkesat në shënime të dërgimit duke përfshirë anekset dhe krahason dokumentet me statusin aktual. Në të njëjtën kohë vulat janë të kontrolluara.

- Inspektimi teknik i trenit që ka mbërritur në stacion bëhet menjëherë pas mbërritjes së trenit. Inspektimi i trenit kryhet nga një inspektor në të dy anët e trenit. Inspektimi i vagonëve në përbërjen e trenit kryhet së bashku me inspektorët nga siper marrja hekurudhore që kryen

dorëzimin të cilët janë të detyruar të eliminojnë të gjitha parregullsitë e identifikuara gjatë inspektimit.

Grafiket e trajtimeve të trenave të mallrave, përfshirë kohëzgjatjen e operacioneve, janë bashkelidhur ketyre rregullave.

7. KONTROLLI I POLICISE KUFITARE

Kontrolli doganor kryhet nga përfaqësuesit e autoriteteve doganore për të dyja palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë këtë fushë si dhe Protokollit të perbashket të nënshkruar mes këtyre autoriteteve zyrtare.

8. KONTROLLI DOGANOR

Kontrolli doganor kryhet nga përfaqësuesit e autoriteteve doganore për të dyja palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë këtë fushë, si dhe Protokollit të perbashket të nënshkruar mes këtyre autoriteteve zyrtare.

9. SHËRBIMET FITOSANITARE, INSPEKTIMET VETERINARE DHE INSPEKTIMET E USHQIMIT

Këto autoritete kryejnë veprimtari kontrolli dhe inspektimi në përputhje me kompetencat e tyre dhe lëshojnë dokumentet shoqëruese në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë këtë fushë si dhe Protokollit të perbashket të nënshkruar mes këtyre autoriteteve zyrtare.

10. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Të gjitha veprimet lidhur me trajtimin e trenave në transportin ndërkombëtar në stacionin kufitar të Tuzit kryhen në përputhje me:

1. Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për organizimin e trafikut kufitar mes dy vendeve; dhe
2. Marrëveshjen ndërmjet transportuesve hekurudhorë të Malit të Zi dhe Hekurudhës Shqiptare - Durrës / HSH / mbi organizimin e transportit hekurudhor të mallrave dhe udhëtareve në vijën kufitare dhe në stacionin e përbashkët kufitar të Tuzit (MONTECARGO prot. numër 3643 datë 21.06.2016 dhe HSH prot. nr. 540, datë 21/06/2016.).
3. Protokollit bilateral të nënshkruar date 21.06.2016 mes autoriteteve hekurudhore të Infrastrukturas hekurudhore të Malit të Zi dhe HSH Menaxhimit të Infrastrukturas hekurudhore;

4. Protokollit te nenshkuar date 20/06/2016 nepermjet autoriteteve zyrtare kufitare te doganave;
5. Protokollit date 01/07/2016 mes policive kufitare;
6. Protokollit date 20/06/2016 ndermjet sherbimeve fito-sanitare, veterinare dhe cilesise ushqimore te te dy vendeve.

Përveç këtyre marrëveshjeve, të gjitha aktivitetet e nevojshme për trajtimin e trenave ndërkombëtar të mallrave do të kryhen në përputhje me Rregulloren e Punës së stacionit te Tuzit.

Udhëheqësi i Njesisë së Podgoricës

Aprovuar nga

Drejtori i Departamentit

(NENSHKRUAR)

(NENSHKRUAR)

SADIK SHIQUERUKAJ

(NENSHKRUAR)

SHTOJCA

**TABELAT GRAFIKE TË EKZEKUTIMIT TË OPERACIONEVE
TREGTARE DHE MALLRAVE DHE INSPEKTIMIT TEKNIK TË
VAGONEVE NE PERBERJE TE TRENIT**